

AKT THEMELIMI I SHOQERISE “KATOS” SHPK

Mbështetur ne Kushtetutën dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikës se Shqipërisë , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private , nismës se lire dhe te veprimtarisë private dhe privatizimit”, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “Për shoqëritë tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Për Q.K.B dhe formalitetet qe duke respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortakut:

- Katuscia Toscano, rruga Guido Dorso 1 Atripalda (Avellino), Italia, Lindur më 11/08/1968, mbajtes i kartes se identitetit me nr. CA39811KH;
- Maria Tosi, rruga B. Zampieri n. 1 D, Verona, Italia, Lindur më 12/09/1964, mbajtes i kartes se identitetit me nr. CA74426DJ;

individë dhe shoqëri me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Vlorë, të krijoj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **“KATOS” SHPK** me akt themelimi si vijon:

NENI 1

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **“KATOS” shpk**. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë Dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit te shoqërisë që do të miratohen nga të dy ortakët themelues:

- Katuscia Toscano, rruga Guido Dorso 1 Atripalda (Avellino), Italia, Lindur më 11/08/1968, mbajtes i kartës së identitetit me nr. CA39811KH;
- Maria Tosi, rruga B. Zampieri n. 1 D, Verona, Italia, Lindur më 12/09/1964, mbajtes i kartes se identitetit me nr. CA74426DJ;

NENI 2

Shoqëria **“KATOS” sh.p.k** ka qendrën në Vlorë, Rruga Sazani, pranë ish kampit te pionerëve, Vlorë dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.. Shoqëria mund të ndryshoj selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale brenda Republikës se Shqipërisë dhe jashtë saj, vetëm me vendim të ortakëve.

NENI 3


Veprimtaria e Shoqërisë “KATOS” Sh.p.k, do të ketë për objekt:

Bar-Restorant-Piceri, organizim eventesh dhe sherbime te ndryshme te ketij lloji. Hoteleri, agjenci turistike dhe organizime udhetimesh, sherbim plazhi, organizim eventesh, import-eksport i cdo produkti, tregtim i produkteve ushqimore, veres, birres dhe pije te cfaredo tipi, agjenci imobiliare, konsulencë për pasuri të paluajtshme të të gjitha llojeve, pjesëmarrja në kontrata publike dhe private, konsulencë marketingu, administrimi i godinave, zhvillimi i softuerit të menaxhimit, e-commerce dhe platformave IT të të gjitha llojeve, Tregtim i pajisjeve per restorante, bar, pasticeri, i veshjeve profesionale te punes. Zhvillimin e kurseve per formim profesional ne fushen e restoranteve, pergatitjen e bukes, picerive, hotelerise etj.

NENI 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat nga 04.06.2022 deri në një afat të pacaktuar.

NENI 5



Kapitali i shoqërisë është LEKE **6.000.000** (gjashtë milion) lek.

Kapitali është i ndarë në **2** kuota, njëra me vlerë **3.000.000** (tre milion) lekë secila.

Kapitali i shoqërisë ndahet sipas ortakëve:

1. Ortaku themelues Katuscia Toscano: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3.000.000 (tre milion) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues Maria Tosi: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 3.000.000 (tre milion) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, i përcaktuar me Vendim të Ortakëve. Administrator do të jetë **Luigi De Lucia** lindur më 23.05.1974, në SAN GIORGIO DEL SANNIO (BN), me leje qëndrimi të lëshuar nga DVKM Vlorë dhe Numër Personal H43523004S, banues në Vlorë, Rruga “Gjergj Arianiti”, Nr.Pasurie 29/394 + 154, Zona Kadastrale 8603.

NENI 7

Te Ardhurat e Shoqërisë ju takojnë Ortakëve në proporcion me përqindjet e kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 8

Ortakët e shoqërisë mund ta shkarkojnë administratorin në çdo kohë me vendim të arsyetuar. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Ortakët me vendim përcaktojnë edhe një ekspert kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

NENI 9

Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tij.

NENI 10

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatë.

NENI 11

Shoqëria do të ketë Vulën dhe Logon e vet.

NENI 12

Akti i themelimit u përpilua ne 5 kopje, një kopje për tju dorëzuar organeve kompetente, nga një kopje Ortakëve të Shoqërisë dhe një kopje do te mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

Akti i Themelimit nënshkruhet prej ortakëve të shoqërisë në datë 04/06/2022.

ORTAKET E SHOQERISE

Katuscia Toscano

Maria Tosi